



Trans Adriatic  
Pipeline

## **Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP)**

Asistenca për Jetesën

dhe Mbështetja Tranzitore në Shqipëri



# Përmbajtja

<b>1. Hyrje</b>	<b>03</b>
<b>2. Profili i Kushteve Sociale</b>	<b>04</b>
<b>3. Asistenca për Jetesën dhe Mbështetja Tranzitore (AJMT)</b>	<b>08</b>
3.1 Objektivat e AJMT	10
3.2 Kriteret e përzgjedhjes për AJMT dhe Grupet Prioritare	11
<b>4. Ndërhyrjet përmes programit AJMT</b>	<b>14</b>
4.1 Studimi i Monitorimit të Marrjes së Tokës Përgjithmonë dhe Vlerësimi i Nevojave të Jetësës	15
4.2 Krijimi i iniciativave për AJMT	16
4.2.1 Restaurimi dhe fuqizimi i jetesës	17
4.2.2 Kriteret pranuese	21
4.2.3 Vlerësimi i propozimeve	21
4.3 Mbështetja Tranzitore për Njerëzit e Cenueshëm	22
4.3.1 Komponentët e Mbështetjes Tranzitore	25
4.4 Procesi i Shqyrtimit	
4.5 Asitenca për Jetesën – Mbështetja Tranzitore -Rastet e Veçanta	26
<b>5. Lidhjet me përfitimet dhe mundësitë e projektit</b>	<b>27</b>
<b>6. Publikimi i AJMT</b>	<b>28</b>
<b>7. Plani i Punës dhe Stafi</b>	<b>30</b>

## Pasqyra e tabelave

Tabela 1: Profili ekonomik i familjeve të prekura nga Rrugët e Aksesit	6
Tabela 2: PAPA/PAHs prioritare	10
Tabela 3: Shpërndarja gjeografike e personave të ndikuar nga projekti TAP	12
Tabela 4: Plani i Punës	23

## Pasqyra e Figurave

Figura 1: Burimet e të ardhurave	7
Figura 2: Qëllimet dhe objektivat e AJTP	9
Figura 3: Instrumenti për Vlerësimin e Shkallës së Cënueshmërisë	11
Figura 4: Programi i Mbështetjes Tranzitore për PAP të cenueshëm	17

# 1. Hyrje

Gazsjellësi Trans Adriatik - TAP ka përgatitur Plane për Restaurimin e Jetesës (LRP) për secilin nga shtetet pritëse. Këto plane përshkruajnë rezultatet e një pune intensive për blerjen dhe servitutin e tokës të ndërmarrë nga projekti TAP dhe kontraktorët e tij dhe përfshijnë të dhëna për angazhimet, procedurat dhe veprimet e ndërmarra për të kompensuar njerëzit dhe familjet që janë ndikuar nga Projekti, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare.

Kërkesa për Performancë 5 e BERZH-it parashikon se kur një projekt shkakton "një humbje të përkohshme ose të përhershme të të ardhurave ose mjeteve të jetesës, për shembull duke ndërprerë ose hequr aksesin e një individi në punësimin e tij/të saj ose në asetet prodhuese", projekti, krahas kompensimit, do të ofrojë si më poshtë:

- Asistencë për jetesë (për shembull, lehtësi në kredi, mundësi për trajnim ose punësim) dhe mundësi për të restauruar, dhe aty ku është e mundur për të përmirësuar, kapacitetet e tyre në gjenerimin e të ardhurave, nivelet e prodhimit dhe standardet e jetesës, dhe;

- Mbështetje tranzitore për personat që janë të zhvendosur ekonomikisht, sipas nevojës, duke u bazuar mbi një përlllogaritje të arsyeshme të kohës që kërkohet për të rehabilituar kapacitetet e tyre për gjenerimin e të ardhurave, nivelet e prodhimit dhe standardet e jetesës.

Standardet ndërkombëtare përcaktojnë një garant të projektit, për të siguruar që personat të cilët janë të ndikuar negativisht më shumë se sa të tjerët nga procesi i blerjes së tokës, dhe të cilët mund të kenë mundësi më të kufizuara për të kërkuar ose përfituar nga kompensimi (p.sh., 'vulnerabel'), të identifikohen dhe të mbështeten në mënyrën e duhur.

Të gjithë pronarët, bashkëpronarët dhe përdoruesit, toka e të cilëve është marrë përgjithmonë dhe/ose marrë me qira përkohësisht nga TAP janë përcaktuar si përfitues të Asistencës për Jetesën dhe Mbështetjes Tranzitore (AJTM). Kjo përfshin njerëzit, të cilët si rezultat i kufizimeve të vendosura nga TAP për asetet fizike dhe burimet natyrore, që ata ligjërisht zotërojnë dhe/ose përdorin, përjetojnë humbje të përkohëshme ose të përhershme të të ardhurave ose jetesës.

Në çdo LRP jepet përmbledhje e një Programi për Asistencën e Jetesës dhe Mbështetjes Tranzitore (AJTM) për të trajtuar këto kërkesa. Ky dokument detajon planin për zbatimin e AJTM në Shqipëri.



Këto plane përshkruajnë rezultatet e një pune intensive për blerjen dhe servitutin e tokës të ndërmarrë nga projekti TAP dhe kontraktorët e tij dhe përfshijnë të dhëna për angazhimet, procedurat dhe veprimet e ndërmarra për të kompensuar njerëzit dhe familjet që janë ndikuar nga Projekti



# 2. Profili i Kushteve Sociale

Në Shqipëri, projekti do të prekë rreth 5000 familje ose afërsisht 20000 njerëz, të cilët zotërojnë dhe/ose përdorin më shumë se 8000 parcela toke, për të cilat projekti kërkon të ketë akses. Afërsisht 15% e familjeve të prekura janë njerëz që përdorin, por nuk e zotërojnë parcelën e tokës. Më poshtë prezantohet një përmbledhje e të dhënave socio-ekonomike që janë mbledhur në një kampion të popullatës së prekur nga projekti, e cila është më shumë e detajuar në Planin e Restaurimit të Jetesës.

Shqipëria është e ndarë në 12 qarqe, secili prej tyre ndahet me tej në bashki dhe në njësi administrative. Projekti TAP prek parcela dhe njerëz që jetojnë në tre qarqe, dhjetë (10) bashki dhe në njëzet e gjashtë (26) njësi administrative (NJ). PAP (Person i Prekur nga Projekti) janë banues në 112 fshatra ku kalon gjurma e projektit.

Në kampionin e familjeve që ndikohen nga projekti, përqindja e të rinjve është dukshëm e ulët dhe raporti i personave të moshuar është më i lartë kur krahasohet me pjesën tjetër të vendit. Në lidhje me arsimin, shumica e kryefamiljarëve (68%), ose e atyre që janë intervistuar si përfaqësues të familjes së tyre, raportojnë se kanë përfunduar arsimin 9 vjeçar ose atë të mesëm, 24% kanë përfunduar vetëm arsimin fillor ndërsa 6% kanë përfunduar universitetin ose shkollë teknike profesionale. Kur merret parasysh niveli i arsimit të gjithë anëtarëve të familjes, përqindja e atyre që kanë përfunduar ose janë në proces të përfundimit të universitetit ose arsimit profesional teknik rritet në 11%.

Përpara krizës financiare globale të vitit 2008, Shqipëria ishte një nga vendet me rritje më të shpejtë ekonomike në Evropë, me një rritje vjetore mesatare prej 6%. Megjithatë, që prej 2008 rritja vjetore ekonomike është përgjysmuar. Ritmi i rritjes po ashtu është reflektuar në nivelin e varfërisë dhe papunësisë: midis 2002 dhe 2008, varfëria në vend ra, afërsisht u përgjysmua (në rreth 12%), por në 2012 ajo u rrit në 14%. Papunësia u rrit nga 13% në 2008 në 17% në vitin 2013, me një nivel të papunësisë të të rinjve që shkoi në 27%. UNDP raporton se gjysma e rinisë në Shqipëri jeton në zonat rurale.

Statistikat kombëtare japin informacion mbi sektorët ekonomikë në të cilët është punësuar popullsia në Shqipëri. Shumica e njerëzve që identifikohen si "të vetëpunësuar" janë të angazhuar në sektorin bujqësor. Raporti më i madh i njerëzve të punësuar me rrogë janë të angazhuar në sektorët e industrisë, shërbimeve dhe ndërtimit.

Bazuar në nevojën për të nisur ndërtimin e gazsjellësit në Shqipëri me punën për rrugët e aksesit dhe urave, është realizuar një sondazh social ekonomik me një kampion të familjeve të prekura duke ndjekur disa faza. Tabela 1 paraqet një profil të familjeve të prekura nga projekti, që janë intervistuar si pjesë e sondazhit social ekonomik për rrugët e aksesit.

**Tabela 1: Profili ekonomik i familjeve të prekura nga Rrugët e Aksesit**

Kriteret	Korça	Fieri	Skrapari
Aktivitetet kryesore që gjenerojnë të ardhurat	65% bujqësi 56% pensione	66% bujqësi 49% pensione	71% bujqësi 50% pensione
Niveli i të ardhurave të familjes	50% poshtë 40,000 lek/muaj	49% poshtë 40,000 lek/muaj	61% poshtë 40,000 lek/muaj
Sipërfaqja e parcelës	Mesatarisht 1.6 ha	Mesatarisht 3.5 ha	Mesatarisht 1.6 ha
Parcelat e kultivuara	77% tregojnë se të gjitha ose shumica e parcelave që kanë janë të kultivuara	90% tregojnë se të gjitha ose shumica e parcelave që kanë janë të kultivuara	64 tregojnë se të gjitha ose shumica e parcelave që kanë janë të kultivuara
Përqindja e fëmijëve që tregojnë se kushtet e tyre të jetesës janë më të këqija sesa ajo e komshijëve të tyre	7%	17%	25%

Ndërmjet familjeve që janë të ndikuara nga stacionet e kompresorëve, punësimi i raportuar në një përqindje të lartë të tyre është: fermerë (38%), ndjekur nga pensionistët (33%). Vetëm 5% e personave të intervistuar e përshkruajnë veten si të 'papunë'.

Për kampionin e familjeve të prekura nga gjurma ku kalon gazsjellësi, raporti është thujse i njëjtë, por me një


përqindje pak më të lartë të kryefamiljarëve që raportojnë se janë fermerë (45%) dhe një përqindje më të ulët (3%) që e përshkruajnë veten si të papunë. Kur përfshihet punësimi i anëtarëve të familjes që janë në moshë pune në familjet e prekura nga projekti, përqindja e papunësisë është më shumë se dyfish, dhe të intervistuarit tregojnë se bëjnë punë të papaguar në shtëpi (shtëpiake), rritet në 11%.



Burimet e të ardhurave dhe masa në të cilën familjet e prekura nga projekti mbështeten në burime të ndryshme të të ardhurave jepet në Figurën 1. Thuhet se 40% e PAP te prekur nga rruget e aksesit dhe stacionet e kompresoreve mbështeten në bujqësi për 50% të të ardhurave të tyre dhe një e treta mbështet 100% në aktivitetet bujqësore.

Niveli i të ardhurave në familjet e prekura nga projekti varion nga 15,000 Lek për muaj në 200,000 Lek. Megjithatë, shumica e të intervistuarëve (53%) kanë raportuar se të ardhurat e tyre mujore variojnë midis 15,000-40,000 Lek në muaj (ose €100-300).

**Figura 1: Burimet e të ardhurave**



Përsa i përket sipërfaqes së tokës që zotërojnë personat e prekur nga projekti, ajo tipikisht varion nga 0.1 ha në 7.5 ha, me një mesatare që është 2 ha për familje. Më shumë se 89% e parcelave të ndikuara janë të kultivuara dhe 90% e PAP raportojnë se përdorin një traktor për të mbljellat bujqësore. Kulturat më të zakonshme që janë raportuar janë gruri (26%), jonxha (23%) dhe pemët frutore (26%). Thuhet se 40% e PAP kanë treguar se ata përdorin produktet e tyre bujqësore për të plotësuar nevojat e tyre në familje dhe për të gjeneruar të ardhura.

Blegtoria vazhdon të luaj një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Megjithatë, vetëm një përqindje e vogël e familjeve të prekura nga projekti raportojnë se mbështeten në blegtori për më shumë se 50% të të ardhurave të tyre, ku 40% e të intervistuarve që preken nga gjurma e tuabcionit kanë raportuar se kanë pula dhe 12% zotërojnë dhi.



“

Kulturat më të zakonshme që janë raportuar janë gruri (26%), jonxha (23%) dhe pemët frutore (26%).

”



# 3. Asistenca për Jetesën dhe Mbështetja Tranzitore (AJMT)

Të drejtat për kompensimin për projektin TAP janë hartuar që të kompensojnë në mënyrë të drejtë ndikimet e shkaktuara nga blerja dhe servituti i tokës. Sidoqoftë vetëm kompensimi nuk garanton restaurimin e jetesës për të gjitha familjet e ndikuar nga Projekti. Për shumicën e personave, toka e të cilëve është marrë me qira gjatë periudhës së ndërtimit të Projektit dhe të cilët kultivojnë kultura vjetore, restaurimi i jetesës do të varet nga menaxhimi i kujdesshëm i të ardhurave të kompensimit si dhe nga rikthimi i tokës në gjendjen e mëparshme. Restaurimi i jetesës do të jetë më sfidues për ata persona, toka e të cilëve është marrë përgjithmonë dhe për ata të cilët kultivojnë kultura shumëvjeçare me rrënjë të thella, brenda zonës së sigurisë të gazsjellësit.

Qëllimi i programit Asistencë për Jetesën dhe Mbështetje Tranzitore (AJMT) është të ofrojë mbështetje që do të mundësojë të gjithë personat e prekur nga projekti, dhe veçanërisht ata që rrezikohen më shumë nga ndikimet negative në jetesën e tyre, të jenë në gjendje të kthejnë nivelin e të ardhurave të tyre në nivelet e para projektit, dhe ta përmirësojnë atë, aty ku kjo është e mundur.

AJMT ka dy komponentë kryesorë: asistencën për jetesën dhe mbështetjen tranzitore. Iniciativat e asistencës për jetesën kanë si qëllim të ofrojnë ndihmë praktike (si p.sh., trajnim dhe inpute bujqësore) për të siguruar që jetesa të jetë rehabilituar plotësisht dhe fuqizuar aty ku është e mundur. Komponenti i mbështetjes tranzitore (grupet vulnerabël) i

AJMT do të fokusohet te identifikimi, monitorimi dhe ofrimi i mbështetjes së përshtatshme të individualizuar, sipas një kohe të caktuar për familjet brenda popullatës së ndikuar nga projekti, e vlerësuar si e "cënueshme" (vulnerabël) dhe në një rrezik të lartë për të qenë e ndikuar në mënyrë jo proporcionale nga marrja dhe servituti i tokës (LEA).

Qëllimet dhe Objektivat e AJMT ilustrohen në Figurën 2 dhe përshkruhen me më shumë detaje më poshtë.



Qëllimi i programit (AJMT) është të ofrojë mbështetje që do të mundësojë të gjithë personat e prekur nga projekti, të jenë në gjendje të kthejnë nivelin e të ardhurave të tyre në nivelet e para projektit, dhe ta përmirësojnë atë, aty ku kjo është e mundur.





**Figura 2.**  
Qëllimet dhe objektivat e AJMT

# 3.1

## Objektivat e AJMT

### Programi i AJMT

përmban pesë objektivat e renditura më poshtë:

- Ofrimin e mbështetjes dhe nxitjes për personat e ndikuar nga projekti, veçanërisht për ata që rrezikohen më së shumti nga ndikimet negative si rrjedhojë e aktiviteteve të LEA-së (sigurimit të tokës), për të investuar dhe fuqizuar jetesën e tyre të bazuar në bujqësi dhe biznes.
- Vendosjen e një sistemi monitorimi efikas për të gjithë PAP-të, duke filluar me procesin e ndjekjes në zonat ku toka është blerë në mënyrë të përhershme, për të vlerësuar nëse pronarët/përdoruesit e tokës kanë qenë në gjendje që ta zëvendësojnë tokën e blerë dhe rehabilituar jetesën e tyre, dhe nëse kërkohet asistencë shtesë.
- Identifikimin monitorimin dhe dhënien e mbështetjes së duhur tranzitore personave/familjeve të ndikuar nga Projekti të cilët konsiderohen si 'vunerabël' për shkak të statusit të tyre social dhe të cilët rrezikohen më shumë nga dëme ekonomike si rrjedhojë e aksesit të tokës nga TAP.
- Dhënien e mundësive për personat e ndikuar nga projekti të interesuar për të fuqizuar aftësitë e tyre të menaxhimit financiar, veçanërisht ata që kanë marrë paketa kompensimi të konsiderueshme, si dhe dhënien e ndihmesës për të identifikuar alternativa të mundshme për investime në mjete të jetesës.
- Garantimin se të gjithë personat e ndikuar nga Projekti janë të mirë informuar dhe kanë akses në përfitime dhe mundësi më të mëdha të projektit.





## 3.2 Kriteret e përzgjedhjes për AJMT dhe Grupet Prioritare

Të gjithë pronarët e tokave, bashkëpronarët dhe përdoruesit, toka e të cilëve është blerë në mënyrë të përhershme dhe/ose është marrë me qira në mënyrë të përkohshme nga TAP, janë përfituesit e synuar nga AJMT. Kjo përfshin njerëzit, të cilët, si rrjedhojë e kufizimeve të vendosura nga TAP në burime fizike (domethënë toka) ose natyrore (domethënë ujë), përjetojnë një humbje të përkohshme ose të përhershme të të ardhurave ose mjeteve të jetesës.

Duke pasur parasysh faktin se tubacioni i gazit kalon në dhjetë bashki në Shqipëri dhe prek më shumë se 8000 parcela toke që përdoren afërsisht nga 5000 familje që jetojnë në 112 fshatra, janë identifikuar grupet prioritare që do të jenë pjesë e burimeve të AJMT. Këto grupe janë përshkruar në [Tabelën 2](#).

**Tabela 2: PAPs/PAHs prioritare**

PAPs/PAHs prioritare	
Grupet e Synuara të AJMT	Shqipëria
Pronarët e tokave të ndikuar nga projekti me një jetesë që bazohet në tokë dhe fermat e të cilëve janë blerë përgjithmonë për stacionet e kompresorëve dhe valvulave të bllokimit.	<b>200</b> Parcela
Fermerët e kulturave shumëvjeçare/pemëtoreve të ndikuar nga DeK-ja e gazsjellësit të cilët do të kufizohen për kultivimin e pemëve dhe kulturave shumëvjeçare me rrënjë të thella brenda Zonës së Kufizimit A.	<b>750</b> Fermerë
Njerëzit e ndikuar nga Projekti që kanë marrë një kompensim për kulturat e tyre, por e kanë të pamundur që të sigurojnë dokumentacionin e mjaftueshëm për të pasur të drejtën ligjore për parcelën e tokës së ndikuar që ata punojnë.	<b>200</b> PAP-të

Për më tepër, është zhvilluar një instrument për të ndihmuar në vlerësimin e niveleve të vunerabilitetit dhe aftësisë për të restauruar jetesën e popullsinë së ndikuar nga Projekti, përshtatur nga faktorët e vunerabilitetit të identifikuar nga Banka Europiane e Investimeve në Manualin e Mjedisor dhe Social të saj (2014).

Ky instrument është përdorur për të kategorizuar PAP-të në grupe me rrezik të lartë (40 % ose më shumë), mesatar (20-40 %) dhe me rrezik të ulët (nën 20 %). Ai do të mundësojë përdorimin më të mirë të të dhënave të mbledhura gjatë proceseve të mëparshme të ndërmarra nga TAP siç janë studimi social-ekonomik (SES) dhe censusi dhe inventari i asetëve (CAI). Ky instrument është prezantuar në Tabelën 3.

**Tabela 3: Instrumenti për Vlerësimin e Shkallës së Vunerabilitetit**

SHTYLLAT	S/N	PARAMETRAT E CËNUESHMËRISË	PESHA %	100
Ekspozimi i PAH-ve ndaj Rreziqeve/Ndikimeve të Dëmshme	1	30% ose më shumë e parcelës së tokës është ndikuar nga TAP-i (Rripi i Punës)	20	40
	2	Bujqësia është aktiviteti kryesor i familjes	5	
	3	Parcela e ndikuar kultivohet me kultura të përhershme	2.5	
	4	Ndodhen në zonat rurale (komunitetet me më pak se 3,400 banorë - Censusi 2011) afër zonës së ndërtimit (afërsisht brenda një korridorit ± 5 km nga gjurma e gazsjellësit)	5	
	5	Parcela e ndikuar kualifikohet nga politikat e tokës jetime të TAP-it si e tillë	2.5	
	6	Përdoruesit e parcelës së ndikuar kanë akses në parcela të tjera që janë më pak se < 0,5 ha	5	
Ndjeshmëria e PAH-ve ndaj Rreziqeve/Ndikimeve	7	Të ardhurat e raportuara të familjes janë në nivelin ose më poshtë kufirit kombëtar të varfërisë	10	30
	8	Kryefamiljari ka tre ose më shumë vartës (dmth. Fëmijë në moshën 18 vjeçare) dhe/ose vartës të moshuar mbi 65 vjeç	5	
	9	Kryefamiljari është 65 vjeç ose edhe më i moshuar dhe jeton me anëtarët e tjerë të familjes	2.5	
	10	Kryefamiljari është 65 vjeç ose edhe më i moshuar dhe është i ve/jeton vetëm	5	
	11	Kryefamiljari ka anëtarë të cilët janë të sëmurë kronik dhe/ose të paaftë për të punuar	5	
	12	Kryefamiljari është prind i vetëm me një ose më shumë fëmijë nën moshën 19 vjeç	2.5	
Kapaciteti përshtatës i PAH-ve	13	Kryefamiljari nuk ka prona të tjera toke dhe pronarët janë gjithashtu kultivues (përdorues) të parcelës së ndikuar	10	30
	14	Kryefamiljari ka asete materiale të kufizuara (dmth. Pajisje fermash, automjete, blegtori)	2.5	
	15	Përveç të ardhurave nga parcela e tokës e ndikuar dhe pensioni, kryefamiljari nuk ka burime të tjera të ardhurash/remitanca	10	
	16	Kryefamiljari ka akses të dobët në infrastrukturën dhe shërbimet bazë (p.sh. banon në një komunitet i cili ka renditje të ulët në Shkallën e Kushteve të Jetesës)	5	
	17	Kryefamiljari nuk ka ose ka arsim formal të kufizuar	2.5	



Të gjithë pronarët e tokave, bashkëpronarët dhe përdoruesit, toka e të cilëve është blerë në mënyrë të përhershme dhe/ose është marrë me qira në mënyrë të përkohshme nga TAP, janë përfituesit e synuar nga AJMT



## PAH: (Familje te Prekura nga Projekti)

Për të asistuar më tej se ku do të përqendrohet programi i AJMT, Tabela 4 identifikon fshatrat përgjatë gjurmës së gazsjellësit ku është edhe një përqendrim i lartë i familjeve të ndikuara nga Projekti, veçanërisht ato brenda grupeve prioritare të përshkruara më lartë.

**Tabela 4: Shpërndarja gjeografike e personave të ndikuar nga projekti TAP<sup>1</sup>**

<sup>1</sup> Të dhënat janë marrë nga përlogaritja e vlerave të kompensimit, Abkons

Persona/Familjet e ndikuara nga Projekti DeK	Qarku Fier	Qarku Berat	Qarku Korçë
Numri total i pronarëve dhe përdoruesve të ndikuar (DeK)	715	920	2349
Bashkitë me më shumë se 500 persona/familje të ndikuara nga Projekti (DeK)	Më afër është Fieri 410	Berat 606	Korça 1174 Devoll 988
Fshatra me më shumë se 50 PAP/PAH (DeK)	Petov, Seman, Qytetit i Roskovecit	Lapardha, Ullinjas, Sqepur, Pobrat, Uznove, Vodice	Dishnice, Belorta, Kuc i zi, Voskop, Floq, Cangoj, Pilur, Kamenice, Plase, Zemlak, Vishoicice, Trestneik, Baban, Billsht, Vranisht
Fshatrat me 10 ose më shumë PAP që kultivojnë kultura shumë vjeçare (DeK)	Petov	Veterrik, Lapardha, Ullinjas, Sqepur, Otlak, Pobrat, Uzonove, Vodice, Poshnje, Kutalli, Rerez	Zemlak, Trestneik, Cangoj, Pilur, Mancurisht, Vranisht

# 4. Ndërhyrjet përmes programit AJMT



## 4.1 Studimi i Monitorimit të Marrjes së Tokës Përgjithmonë dhe Vlerësimi i Nevojave të Jetësës



Të gjithë pronarët dhe përdoruesit e ndikuar nga Projekti do të monitorohen për të siguruar se jetesa e tyre është restauruar, duke filluar me ata që janë ndikuar nga marrja e përhershme e tokës.



Si pjesë e angazhimit të TAP-it për të restauruar jetesën e atyre personave që janë prekur nga marrja e tokës nga projekti, të gjithë pronarët dhe përdoruesit e ndikuar nga Projekti do të monitorohen për të siguruar se jetesa e tyre është restauruar, duke filluar me ata që janë ndikuar nga marrja e përhershme e tokës, që kërkohet për ndërtimin e stacioneve të kompresorëve dhe valvulave bllokuese. Një studim monitorimi do të ndërmerret për të dokumentuar suksesin e PAP-ve për të zëvendësuar tokën e marrë ose investuar në parcela të tjera alternative që kanë në pronësi, si dhe për të kuptuar progresin e bërë për rikthimin e aktiviteteve të jetesës të cilat janë ndikuar nga TAP. Studimi do të vlerësojë gjithashtu se cilat forma të asistencës dhe/ose trajnimit do të shërbenin për të fuqizuar mirëqenien e tyre ekonomike. Gjetjet nga studimi i ndjekjes do të integrohen në programin AJMT, përshkruar në rubrikat e mëposhtme.





## 4.2 Krijimi i iniciativave për AJMT

Asistenca dhe trajnimi shtesë për jetesën, synon që të sigurojë restaurimin e jetesës dhe ta fuqizojë atë aty ku është e mundur, do të arrihet duke iu bërë thirrje për propozime agjencive të kualifikuara zbatuese brenda Shqipërisë. Rezultatet paraprake për vlerësimin e partnerëve zbatues ndërmarrë nga TAP, tregojnë se ka një numër organizatash të fuqishme që kanë eksperiencë në bujqësi dhe zhvillimin rural.

Rubrikat më poshtë ofrojnë detaje të tjera për zonat e fokusuar për propozime, kriteret e përzgjedhjes dhe procesin e vlerësimit.

## 4.2.1

### Restaurimi dhe fuqizimi i jetesës

**'Thirrja për propozime' për programin e Asistencës për Jetesë do të nxisë dorëzimin e propozimeve që ndahen në katër kategoritë e mëposhtme.**

#### Projektet për Përgatitjen e Parcelave të Tokës

Projektet për Përgatitjen e Parcelave të Tokës (LPPP-të), u ofrojnë familjeve të zhvendosura nga parcelat e tokës të kultivuara më parë, të cilat synojnë të vijojnë të merren me bujqësi pas rikthimit të tokës, asistencë të përshtatshme për të mbështetur përpjekjet e tyre për të rifilluar bujqësinë në mënyrë të shpejtë. Format e mbështetjes përfshijnë punën manuale shtesë për të ndihmuar fermerët që të përgatisin parcelën e tyre për mbjellje dhe/ose akses në shërbime me traktor. Gjithashtu, mund të përfshijnë një akses të përmirësuar (p.sh., ulja e kostove përmes blerjeve në sasi të mëdha) për plehra kimike, farëra dhe pesticide të nevojshme. Për fermerët e kulturave shumëvjeçare, të cilët do të kenë kufizime për ri-mbjelljen e këtyre kulturave me rrënjë të thella brenda zonës së sigurisë në parcelën e tyre të ndikuar, do të ofrohet mbështetje teknike dhe në natyrë për të vlerësuar kulturat alternative që mund të mbillen në zonën e kufizuar dhe për t'u përgatitur për kultivimin e tyre.

#### Projekti i Kultivuesve të Pemëve Shumëvjeçare

Fokusi i këtyre ndërhyrjeve do të jetë te nevojat për jetesë të personave të ndikuar nga Projekti të cilët mbështetësin ekonominë e tyre në rritjen dhe kultivimin e pemëve shumëvjeçare, dhe të cilët do të kenë kufizime për mbjelljen përsëri të këtyre pemëve me rrënjë të thella brenda zonës së sigurisë së gazsjellësit. Çdo PAP i interesuar do të ketë të drejtë për të marrë pjesë në një seancë konsultimi me një ekspert bujqësor, i cili do t'i ndihmojë ata me përgatitjen e një plani individual për restaurimin e jetesës që përfshin aspekte të tilla si:

- Alternativa për kultivimin e kulturave të ndryshme, të cilat nuk janë me rrënjë të thella por me një vlerë të ngjashme ekonomike brenda zonës së sigurisë;
- Rritjen e vlerës prodhuese (dhe/ose të tregut) të pemëve shumëvjeçare që kanë mbetur në parcelën e ndikuar të tokës;
- Prezantimin e formave të reja të kultivimit ose përmirësimit e atyre ekzistuese në parcelat e tjera në pronësi të PAP jashtë zonës së projektit;

- Eksplorimin e aktiviteteve alternative të gjenerimit të të ardhurave dhe ofrimin e mbështetjes së kërkuar (p.sh., trajnim, kapital monetar për të ngritur një biznes) për të kaluar në këto aktivitete të reja.

- Kërkimin e mundësisë së programeve financuese ekzistuese (ose të ardhshme) qeveritare dhe/ose të BE-së për iniciativat bujqësore për të cilat mund të kualifikohen PAP-të dhe asistencë që do t'ju duhej për përgatitjen dhe dorëzimin e aplikimeve



Fokusi i këtyre ndërhyrjeve do të jetë te nevojat për jetesë të personave të ndikuar nga Projekti





## Projektet për Përmirësimin e Bujqësisë

Projektet për Përmirësimin e Bujqësisë (AIP-të) do të nisin në zonat kyçe përgjatë gjurmës së gazsjellësit për të ofruar mbështetje teknike dhe trajnim për familjet e ndikuara dhe të interesuara për të vlerësuar përfitimet dhe përfutur praktikatat e përmirësuara bujqësore në parcelat e tyre të tokës.

AIP-të do të ofrojnë trajnim për fermerët për të mësuar dhe punuar me praktika të përmirësuara bujqësore në periudhën përpara se parcela e tyre e tokës të jetë rikthyer. Pas rikthimit të tokës, fermerët pjesëmarrës do të pajisen me informacion dhe lëndë të përmirësuara dhe trajnim shtesë për të siguruar përfitim të shpejtë të praktikave të përmirësuara. AIP-të do të duhet të përshtaten sipas kontekstit specifik të komunitetit dhe nevojave bujqësore të PAP-ve përgjatë gjurmës së gazsjellësit ku ato do të krijohen. Komponentë të mundshëm do të përfshijnë:

- Trajnimin e trajnuesve të komunitetit të fermerëve (p.sh., trajnimin e PAP që mund të bëhen trajnues të fermerëve në komunitetet e tyre)
- Krijimin e fermave familjare për demonstrim
- Mbështetjen teknike për fermerët e zhvendosur
- Mbështetje në akreditimin dhe çertifikimin e produkteve që lidhen me bujqësinë/blegtorinë
- Rrugët për të pasur akses në pajisje të përmirësuara bujqësore dhe inpute bujqësore të përmirësuara



AIP-të do të ofrojnë trajnim për fermerët për të mësuar dhe punuar me praktika të përmirësuara bujqësore në periudhën përpara se parcela e tyre e tokës të jetë rikthyer.





### Grante për Zhvillimin e Bizneseve për Familjet e Ndikuara nga LEA

Programi i Granteve për Zhvillimin e Bizneseve për familjet e ndikuara nga LEA (marrja dhe servituti i tokes) do t'i mundësojë anëtarët të familjeve të ndikuara nga LEA që plotësojnë kriteret të pajisen me grante për zhvillimin e bizneseve të vogla familjare që synojnë të arrijë iniciativa më premtuese për bizneset familjare.

Grantet e vogla do t'u mundësonin familjeve, që janë të afta të tregojnë se kuptojnë qartësisht menaxhimin financiar dhe kanë aftësi për biznes të vogël, akses të një kapital për të zgjeruar ose zhvilluar idetë e reja për biznes të vogël familjar. Duke u fokusuar te ato familje të zhvendosura që kanë treguar se kanë kapacitetet për menaxhim financiar, shkalla e suksesit e granteve të vogla

do të rritej dhe ndërkohë familjet e tjera të zhvendosura do të kishin modele të suksesshme të bizneseve familjare me bazë në komunitet.

Grantet e vogla mund të strukturoren sipas një procesi hap pas hapi, duke ofruar në fillim një grant për fillimin e biznesit për familjet e përzgjedhura dhe një grant tjetër zhvillimi edhe më i madh është i mundshëm bazuar mbi performancën dhe suksesin e grantit të parë. Prioritetet do t'u jepet bizneseve të propozuara nga gratë, të rinjtë dhe kur është e mundur ato propozime që vijnë prej personave vulnerabël brenda familjeve të ndikuara nga LEA.

Një proces i detajuar në lidhje me të drejtën për t'u përzgjedhur dhe procesin e përzgjedhjes do t'u komunikohet qartësisht familjeve të ndikuara nga projekti.



## 4.2.2

### Kriteret pranuese

Organizatat që kualifikohen për të dorëzuar propozime përmes procesit të Thirrjes për Propozime për programin AJMT duhet të jenë një entitet i regjistruar ligjërisht brenda Republikës së Shqipërisë, me kapacitete të shfaqura për zbatimin e programit që janë duke propozuar dhe të aftë për të përmbushur kërkesat e pajtueshmërisë dhe kodit të sjelljes së TAP-it.

## 4.2.3

### Vlerësimi i propozimeve

**Kriteret e vlerësimit do të përfshijnë shkallën e përputhshmërisë së propozimeve me objektivat e mëposhtëm:**

- Kanë si objektiv grupet prioritare të përmendura më sipër brenda popullatës së njerëzve të ndikuar nga LEA;
- Ofrojnë incentiva për PAP-të për t'i investuar kompensimet e tyre për rikthimin dhe fuqizimin e aktiviteteve të tyre aktuale bujqësore;
- Ndihmojnë në restaurimin dhe përmirësimin e prodhimtarisë bujqësore veçanërisht në zonat ku ndikimet e LEA-së janë të larta dhe me grupet prioritare brenda popullsisë së ndikuar nga Projekti;
- Tregojnë se nevojat dhe interesat që lidhen me jetesën e grave dhe të rinjve brenda familjeve të ndikuara nga Projekti janë marrë në konsideratë;
- Kanë të dhëna të qarta të mbështetjes për propozimin nga aktorët kyç në zonat e ndikuara nga Projekti, veçanërisht të vetë njerëzve të ndikuar nga projekti;
- Janë të harmonizuara me prioritetet e zhvillimit rural të qeverisë vendore dhe rajonale;
- Përfshijnë një komponent të fortë monitorimi për të matur progresin, performancën dhe përputhshmërinë financiare

Një plan pune për zbatimin e procesit të thirrjes për propozime përfshihet në Rubrikën 9 dhe do të nisë në tremujorin e katërt të vitit 2016.

## 4.3 Mbështetja Tranzitore për Njerëzit e Cenueshëm



Personat vunerabël janë përkufizuar nga BERZH si ata të cilët, "për shkak të gjinisë, etnisë, moshës, paaftësisë mendore ose fizike, disavantazhit ekonomik, ose statusit social, mund të jenë të ndikuar në mënyrë më të pafavorshme nga aksesit në tokë se sa të tjerët, dhe të cilët mund të kenë aftësi të kufizuara për të kërkuar ose përfituar nga asistenca e zhvendosjes dhe përfitime të tjera zhvillimi".

Për më tepër, standardet kërkojnë që të kushtohet vëmendje e veçantë nevojave të të varfërve dhe personave vunerabël gjatë planifikimit të zhvendosjes. Propozuesit e projektit pritet që të identifikojnë individët dhe grupet, mirëqenia e të cilëve mund të jetë zvogëluar në mënyrë jo të barabartë dhe jo proporcionale nga projekti për shkak të gjendjes së tyre në disavantazh dhe në pozicion të cenueshëm; dhe aty ku këto grupe identifikohen, të propozojnë dhe zbatojnë masa për të zbutur ndikimet e dëmshme në këto grupe. Projektet që nuk ndërmarrin këto lloj ndërhyrjesh rrisin rrezikun e përkeqësimit të cenueshmërisë ekzistuese dhe madje krijojnë varfëri të reja.

Vunerabiliteti mund të ketë qenë i pranishëm edhe më parë (i pranishëm në një Zonë të Projektit përpara se të fillojnë aktivitetet e Projektit) ose i shkaktuar nga Projekti (si rezultat i aktiviteteve të Projektit). Ka gjithashtu raste kur një person që konsiderohet si i cenueshëm përjeton një përkeqësim të situatës si rezultat i Projektit. Komponenti i Mbështetjes Tranzitore i AJMT ka në fokus individët dhe familjet që janë në rrezik të madh nga ndikimet negative si rrjedhojë e programit për blerjen dhe servitutin e tokës të TAP-it.

Ekipi i LEA ka mbështetur PAP të vlerësuar si "vunerabël" si rrjedhojë e sfidave para-ekzistuese që lidhen me çështjet e shëndetit, lëvizshmërisë dhe të të kuptuarit, gjatë Censurit dhe Inventarit të Aseteve (CAI) dhe procesit për Sigurimin e Aksesit të Tokës (SLA). Kjo asistencë është ofruar në disa forma duke përfshirë organizimin e takimeve informuese dhe firmosjen e kontratës me PAP të cenueshëm në shtëpitë e tyre dhe në praninë e anëtarëve të familjes dhe ndihmësve të tjerëve brenda rrjetit mbështetës të PAP-ve. LEA ka ndihmuar gjithashtu PAP-të me transportin për të shkuar në bankë, në takimet me noterë dhe në kryerjen e pagesave të kompensimit si dhe ka përfshirë përfaqësuesit e bankave duke i bërë pjesë të takimeve të tyre për SLA

për të ndihmuar PAP-të që nuk kanë një llogari bankare, të hapin një të tillë.

Që prej Prillit të 2016, LEA po ndihmon PAP që kanë vullnetin për të nënshkruar marrëveshjet për tokën, por që nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë sepse u mungon dokumentacioni i nevojshëm i pronësisë për të marrë kompensimin në kohën e duhur. Më tej, gjatë aktiviteteve të Njoftimit dhe Hyrjes në Parcelë që drejtohet nga Kontraktorët EPC të TAP, LEA ka shoqëruar dhe monitoruar procesin për të (i) përforcuar mesazhin e dhënë të PAP gjatë Procesit të Marrjes së Tokës; (ii) ofruar mbështetje dhe informacion sikurse kërkohet dhe (iii) vazhduar ruajtjen e marrëdhënive të mira të vendosura me PAP dhe komunitetet. Çdo PAP që mund të kërkojë ndihmë të veçantë gjatë ndërtimit dhe fazës së Daljes nga Parcela vazhdon të identifikohet dhe nevojat e tyre do të konsiderohen dhe mbështeten.

Një "Listë Vëzhgimi për Familjet Vulnerabël" është përpiluar për të ndihmuar në identifikimin dhe monitorimin e vazhdueshëm të atyre PAP-ve që kërkojnë trajtim të veçantë, dhe/ose konsiderohen se rrezikohen më shumë se të tjerët nga ndikimet e dëmshme që vijnë nga procesi i aksesit të tokës. Lista paraprake është hartuar nga LEA, duke u bazuar kryesisht te familjet e dobëta brenda censurit të LEA-s dhe bazës me të dhëna social-ekonomike mbështetur në instrumentin e vlerësimit të cenueshmërisë të paraqitur në Figurën 3. Disa PAP janë referuar nga ekipi i SLA dhe stafi i TAP-it për angazhimin me grupet e interesit dhe menaxhimin ankesave.



Propozuesit e projektit pritet që të identifikojnë individët dhe grupet, mirëqenia e të cilëve mund të jetë zvogëluar në mënyrë jo të barabartë dhe jo proporcionale nga projekti për shkak të gjendjes së tyre në disavantazh dhe në pozicion të cenueshëm



### Komponentët e Mbështetjes Tranzitore

Programi i Mbështetjes Tranzitore do të përfshijë një proces me katër hapa, siç edhe ilustron në Figurën 3. Ai do të zbatohet përmes një organizate si palë e tretë, që do të identifikohet përmes procesit të thirrjes për propozime për AJMT, me eksperiencë pune me grupet e cenueshme në zonat e projektit. Një numër agjencish potenciale zbatuese janë identifikuar përmes procesit të ndërmarrë së fundmi nga ekipi i Investimeve Sociale dhe Mjedisore.

**Figura 3: Programi i Mbështetjes Tranzitore për PAP të cenueshëm**

#### Lista e Vëzhgimi për Cenueshmërinë

Përcaktimi i kriterëve për identifikimin e personave/familjeve të prekura nga projekti (PAH) që kanë potencial për të qenë të cenueshëm, formalizimi i procesit referues + përditësimi i vazhdueshëm i Listës së Vëzhgimit.

#### Analizimi + Vlerësimi i Vizitave në Familje

Agjencia zbatuese rishikon listën e vëzhgimit + kontaktet, PAH-të me të drejtë përzgjedhje, për të marrë më shumë informacion në lidhje me cenueshmërinë, nevojat e veçanta dhe rekomandon plane të individualizuara për mbështetje tranzitore

#### Vlerësimi i të drejtës për t'u përzgjedhur

LEA vlerëson rekomandimet e agjencisë zbatuese për mbështetje tranzitore

#### Dhënia e Mbështetjes & Vazhdimi

Llojet e mbështetjes do të përshtaten sipas çdo PAH-je por mund të përfshijnë: asistencë për aksesimin e programeve/shërbimeve ekzistuese vendore, vëmendje prioritare për iniciativa të tjera për asistencë të jetesës, ose në raste të veçanta mbështetje me lekë ose/ dhe në natyrë.



### 4.3.1

## Procesi i Shqyrtimit

Hapi i parë në procesin e shqyrtimit është Lista e Vëzhgimit për Vunerabilitetin (Cenueshmërinë) hartuar nga konsulenti Social i LEA-s. Informacioni i disponueshëm për familjet e prekura nga Projekti në listën e vëzhgimit do të rishikohet më tej nga agjencia zbatuese për Mbështetje Tranzitore dhe nga vizitat në familje të PAP-të. Vizita në familje është pjesë e procesit formal dhe konfidencial të shqyrtimit dhe vlerësimit për të mbledhur informacion për:

- Rrethanat e familjes, duke përfshirë detajet e sfidave me të cilat ato përballen, dhe ndikimet potenciale që vijnë si rezultat i aktiviteteve të TAP-it për blerjen dhe servitutin e tokës, veçanërisht në lidhje me sigurinë e ushqimit;
- Detajet e ndërlikimeve të cenueshmërisë, duke përfshirë: çështjet e lëvizshmërisë, kapacitetet e kuptimit, nivelin e mbështetjes sociale të ofruar;
- Përfundimin për kategorizimin si të cenueshëm dhe rekomandimet në lidhje me format e propozuara të mbështetjes.

Planet e individuale për mbështetje tranzitore do të marrin në konsideratë llojet e asistencës së mëposhtme:

- Mbështetje e specializuar në procesin SLA, (p.sh., PAP-të që nuk kanë dokumentet e duhura ligjore);
- Monitorimin e kërkesave për mbështetje dhe/ose dhënien e prioritetit në procesin e rikthimit të tokës dhe programet e asistencës së jetesës;
- Aty ku mund të ekzistojnë përfitime specifike të dhëna nga qeveria ose institucione të tjera për të cilat PAP-të e ndikuar nuk janë në dijeni ose nuk kanë pasur mundësi t'i sigurojnë, dhënia e asistencës për vlerësimin me organizatat të së drejtës së tyre për t'u përzgjedhur për përfitime të tilla sociale dhe për dorëzimin e aplikimeve për shqyrtim;
- Asistencë e veçantë (asistencë mjekësore) për një periudhë të caktuar tranzitore gjatë së cilës ekziston një rrezik i lartë që një familje të përballlet me kufizime si rezultat i Projektit TAP (aty ku është e përshtatshme Shkalla e Aksesit të Pasigurt në Ushqim (HFIAS) mund të përdoret si një metodë për vlerësimin dhe monitorimin e ndryshimeve në nivelin e pasigurisë së ushqimit brenda një familje të cenueshme).

LEA do të vendos një proces të brendshëm për të vlerësuar dhe miratuar rekomandimet e partnerit zbatues për mbështetje brenda parametrave të pranuar.

Asnjë vendim në lidhje me të drejtën për t'u përzgjedhur për këtë program nuk do të bëhet gjatë Vizitës në Familje. Më së shumti, do të jetë një ushtrim për mbledhjen e informacionit bazuar mbi një instrument vlerësimi të zhvilluar nga agjencia zbatuese e kontraktuar për të zbatuar këtë program. Kjo do t'i komunikohet qartësisht familjes. LEA do të shqyrtojë gjetjet e vlerësimeve familjare dhe sigurojë se miratimi i duhur është marrë nga TAP-i, për rastet kur referimi të një ofruesi në një shërbim ekzistues dhe vazhdimi në të ardhmen nuk është i sigurt dhe rekomandohet asistencë e veçantë.



LEA do të shqyrtojë gjetjet e vlerësimeve familjare dhe sigurojë se miratimi i duhur është marrë nga TAP-i, për rastet kur referimi të një ofruesi në një shërbim ekzistues dhe vazhdimi në të ardhmen nuk është i sigurt dhe rekomandohet asistencë e veçantë.





## 4.4

### Asitenca për Jetesën – Mbeshtetja Tranzitore -Rastet e Veçanta

Megjithëse nuk janë parashikuar ndikime në jetesën e banorëve që mbështeten te peshkimi në zonën bregdetare, LEA do të vlerësojë çdo rast të identifikuar përmes mekanizmit të ankesave ose nga stafi i TAP-it për angazhimin e palëve të interesit për asistencë të duhur për jetesën dhe/ose mbështetje tranzitore.

# 5. Lidhjet me përfitimet dhe mundësitë e projektit



LEA do të përpiqet të sigurojë që personat e ndikuar nga Projekti janë identifikuar qartësisht dhe përfshirë në çdo strategji komunikimi ose strategji për angazhimin e palëve të interesit dhe për të gjetur rrugë sipas të cilave PAP-të mund të përfshihen për planifikimin e investimeve dhe zbatim. Monitorimi LEA do të përfshijë mbledhjen e të dhënave nga projekti, që ndjek pjesëmarrjen e njerëzve të ndikuar nga blerja dhe servituti i tokës së TAP drejtpërsëdrejti në projektet e tyre, veçanërisht të atyre PAP-ve të konsideruar si të 'cenueshëm'.

LEA do të shqyrtojë planet e Kontraktorit për zbatimin e punësimit dhe trajnimit për të kuptuar më mirë se si kontraktorët synojnë të rekrutojnë punonjësit nga komunitetet vendore, dhe do t'i jap informacion ESMS-së në lidhje me strategjinë e komunikimit për të siguruar që anëtarët e familjeve të ndikuara nga Projekti, veçanërisht të rinjtë, të jenë të informuar se si këto mundësi mund të aksesohen. Përsëri, çdo e dhënë që mund të merret nga kontraktorët (ose përmes regjistrave të punësimit vendor) për PAP-të që janë të aftë të aksesojnë mundësitë për punësim në lidhje me TAP-in do të mblidhen si pjesë e monitorimit të LEA.





## 6. Publikimi i AJMT

Programi i AJMT do të prezantohet në një sërë takimesh me grupet e interesit (duke përfshirë edhe takime me komunitetin e PAP) dhe po ashtu do të përgatitet dhe do të shpërndahet një borshurë. Do të ngarkohet në faqen e internetit të TAP, dhe do të jetë e disponueshme për të gjitha zyrat rajonale të TAP-it në gjuhën shqipe.





Për më shumë informacion,  
ju lutemi vizitoni faqen tone në:  
**[www.tap-ag.al](http://www.tap-ag.al)**

Trans Adriatic Pipeline AG Shqipëri,  
Ndërtesa Nr. 12 (ABA Business Center),  
Kati 9, Zyra Nr. 906

Rruga Papa Gjon Pali II  
1010 Tiranë, Shqipëri  
Tel: +355(4)4 306 937  
Fax: +355(4)2 265 685  
[tapshqiperi@tap-ag.com](mailto:tapshqiperi@tap-ag.com)